



AKT THEMELIMI

Data 15.04.2021

1. Z. LUAN SHABA, atesia Elmaz, i dtl. 13.08.1985, lindur ne Durres dhe banues ne Durres madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, shtetas shqiptar, identifikuar nga leternjoftimi nr. I50813062W;

2. Znj. ENI SHABA, atesia Sherif, e dtl. 05.11.1992, lindur ne Durres dhe banuese ne Durres madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, shtetase shqiptare, identifikuar nga leternjoftimi nr. J26105078D;

Te dy perfaqesohen me prokure te huaj, date 22.03.2021, nga Z. Sherif Konçi, me nr. personal F80503163A;

te cilet mbeshtetur ne ligjin Nr.9901, dt.14/04/2008, "Per Shoqerite Tregtare" dhe ne legjislacionin shqiptar ne pergjithesi, vendosen si vijon:

Emertimi, Selia dhe afati i Shoqerise

Neni 1

Te themelojne shoqerine me pergjegjesi te kufizuar, per te zhvilluar veprimtari tregtare. Shoqeria eshte person juridik shqiptar, veprimtaria e te ciles rregullohet nga akt themelimi, statuti i saj dhe legjislacioni ne fuqi.

Neni 2

Shoqeria do te emertohet "**ASIA 2021**"sh.p.k.

Neni 3

Shoqeria do te kete seline e saj ne Durres, ne adrese rr. "Nako Spiru", lagjja nr. 1, me nr. pasurie 23/328-ND+1-35.

Neni 4

Shoqeria do te zhvilloj aktivitetin e saj me afat te pakufizuar. Afati mund te ndryshohet me vendim te Asamblese se Ortakut.

Shoqeria "ASIA 2021" sh.p.k. gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin e QKB-se.

Neni 5

Shoqeria "ASIA 2021"sh.p.k. do te kete si objekt:

Shitje rroba te importuara nga Italia, produkte importi, import-eksport mallrash.

Si edhe çdo gje tjeter qe nuk bije ne kundersizim me ligjin.

Neni 6

Selia e shoqerise mund te transferohet.

Neni 7

Kur shoqeria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e perfitojne ortakët e saj.

Ortakët themelues perballojne humbjet e shoqerise deri ne kufirin e vleres se saj te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Kapitali baze mund te rritet nga fitimi ne natyre, ose kredi ne leke ose valute qe merret ne Bankat e Shtetit Shqiptar.

Kapitali themeltar per vazhdimin e aktivitetit te shoqerise eshte ne shumen 10.000 (dhjete mije) leke, qe i takon ortakut themelues si me poshte:

1. Z. LUAN SHABA zoteron 1 kuote, me vlere 50% te kapitalit;

2. Znj. ENI SHABA zoteron 1 kuote, me vlere 50% te kapitalit.

Fitimet qe do te evidentohen pas miratimit te bilancit vjetor nga Asambleja e Ortakeve pas zbritjes se taksave do te ndahen si vijon:

- Fondi rezerve.
- Shperblimi qe i takon ortakeve themelues.

Neni 8

Shoqeria mund te hyje ne veprimtari te perbashketa me shoqeri te tjera shqiptare ose te huaja edhe kur ato nuk kane objekt aktiviteti ate te shoqerise.

Neni 9

Veprimtaria e shoqerise mund te ushtrohet duke krijuar filiale ose perfaqesi brenda dhe jashte vendit, konform me ligjin shqiptar ose te huaj.

Te drejtat dhe detyrat e Ortakut:

Ortaku gezon keto te drejta kryesore:

Neni 10

- Administrimin e veprimtarise ne perputhje me akt themelimin dhe statutin.
- Pjesmarrjen ne rezultatet e çdo forme dhe sasie te veprimtarise se shoqerise e parashikuar ne statutin e saj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblese dhe organet e tjera te shoqerise.
- Te heqe dore nga shoqeria, heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise.
- Te marri pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen nepermjet perfaqesuesit te tij ose vete.
- Te emeruje dhe te shkarkoje perfaqesuesit e tij, punonjesit, ekspertin kontabel dhe likuidatoret.

Ortaku ka keto detyrime kryesore:

- Te depozitoje kuoten e tij dhe kuoten suplementare ne perputhje me akt themelimin dhe statutin.
- Te marri pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara nga vete ata.
- Ti japi shoqerise te dhenat e domosdoshme per perpunimin e çdo objekti te vecante lidhur me veprimtarine e saj.
- Te kryeje detyrat per realizimin e objektivave dhe te funksioneve te shoqerise.
- Ka detyrimin nese heq dore nga shoqeria ti njoftojne vendimin e tij asamblese 6 muaj perpara dhe duke ceduar te drejten e zgjedhjes.
- Ti japi shoqerise informatat e nevojshme qe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.
- Te kryeje sherbimet e nevojshme per arritjen e objektivave te shoqerise dhe realizimin e funksioneve te saj.

ADMINISTRIMI

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e Ortakut.



Neni 11
Administratori

Veprimtaria opefative e shoqerise drejtohet nga Administratori i saj i Pergjithshem. Ne shoqerine ""ASIA 2021" sh.p.k. administrator i shoqerise do te jete:

Z. LUAN SHABA, atesia Elmaz, i dtl. 13.08.1985, lindur ne Durres dhe banues ne Durres madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, shtetas shqiptar, identifikuar nga leternjoftimi nr. I50813062W; i cili ne te njejten kohe ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithë veprimtarine e saj.

Administratori emerohet per nje kohezgjatje prej 5 (pese) vjetesh financiare.

Me miratimin e ortakeve mund te emerohen administratore dhe perfaqesues te tjere te shoqerise "ASIA 2021" sh.p.k. Administratoret emerohen per nje kohezgjatje prej 5 (pese) vjetesh financiare me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faj te tij gjate administrimit te shoqerise.

Neni 12

Mbyllja e Shoqerise

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin e bere nga ortakut, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise.

Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

Neni 13

Kur shoqeria likujdohet

Asambleja e ortakut emeron likujdatorin, dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij bilanci te likujdimit. Komisioni i Likujdimit perbehet nga nje ose tre antare. Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne vartesi te shkalles se konsumit te tyre. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

Neni 14

Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Ortakut.

Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine.

Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujdatoreve.

Dispozita te hollesishme mbi organizimin e kesaj shoqerie percaktohen ne statutin e saj.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE


LUAN SHABA

Perf. Nga Sherif Konçi

Sherif Konçi


ENI SHABA

Perf. Nga Sherif Konçi

Sherif Konçi




S T A T U T
I SHOQERISE "ASIA 2021" sh.p.k.

Data 15.04.2021

KREU I-re

Dispozita te Pergjitheshme

NENI 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "ASIA 2021" sh.p.k., eshte themeluar sipas akt themelimit dhe ketij statuti te perpiluara dhe nenshkruara nga ortaket e saj:

1. Z. LUAN SHABA, atesia Elmaz, i dtl. 13.08.1985, lindur ne Durres dhe banues ne Durres madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, shtetas shqiptar, identifikuar nga leternjoftimi nr. I50813062W;

2. Znj. ENI SHABA, atesia Sherif, e dtl. 05.11.1992, lindur ne Durres dhe banuese ne Durres madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, shtetase shqiptare, identifikuar nga leternjoftimi nr. J26105078D;

Te dy perfaqesohen me prokure te huaj, date 22.03.2021, nga Z. Sherif Konçi, me nr. personal F80503163A;

Kjo shoqeri mbeshtetur ne ligjin Nr.9901 dt.14/04/2008, "Per Shoqerite Tregtare" dhe ligjin nr. 9723 dt. 03/05/2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", krijohet nga "Ortaket" per te ushtruar veprimtari te perbashket sipas parashikimeve te bera ne Aktin e Themelimit dhe nga ky Statut.

Emertimi i shoqerise eshte "ASIA 2021" sh.p.k.

Shoqeria eshte krijuar me mjetet ne pronesi te themelueseve te saj. Ajo rregullon poziten juridike te themeluesve dhe punonjesve ne shoqeri, te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik, organizimin, objektin e veprimtarise dhe ceshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

Shoqeria "ASIA 2021" sh.p.k. eshte person juridik shqiptar dhe e fiton kete te drejte qe nga momenti i regjistrimit te shoqerise ne regjistrin e QKB-se Durres.

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit, sigurise dhe te rentabilitetit.

NENI 2

Shoqeria "ASIA 2021" sh.p.k. do te kete si objekt:

Shitje rroba te importuara nga Italia, produkte importi, import-eksport mallrash.

Si edhe çdo gje tjeter qe nuk bije ne kundersiztim me ligjin.

NENI 3

Shoqeria do te kete seline e saj ne Durres, ne adrese rr. "Nako Spiru", lagjja nr. 1, me nr. pasurie 23/328-ND+1-35.

Ajo mund te çele filiale, dege dhe perfaqesi ne qytete te tjera te Shqiperise, ne perputhje me Legjislacionin Shqiptar.

NENI 4

Shoqeria pergjigjet per detyrimet e saj me fondet e veta.

KREU II-te

Te drejtat dhe detyrat e Ortakeve:

NENI 5

Ortakët gezojnë këto të drejta kryesore:

- Pjesëmarrjen në rezultatet e çdo forme dhe sasi të veprimtarisë së shoqërisë e parashikuar në kontratën dhe statutin e saj.
- Marrjen e të gjitha të dhënave që kanë të bëjnë me gjendjen ekonomike tregtare dhe veprimtarinë e shoqërisë, si dhe me të gjithë dokumentat e përpunuara nga shoqëria, bilancet si dhe llogaritë ekonomike etj.
- Paraqitjen e propozimeve dhe shqyrtimin e tyre nga Mbledhja e Asamblese së Ortakut.
- Të heqë dorë nga shoqëria.
- Heqja dorë nga shoqëria nuk e liron ortakun nga detyrimet financiare të marra me pare ndaj shoqërisë.
- Të marrë pjesë në organet e shoqërisë që janë ose mund të krijohen nëpërmjet përfaqësuesve të tij ose vete.
- Të kërkojë t'i japin të gjitha informatat që kanë të bëjnë me gjendjen prodhuese dhe tregtare të shoqërisë, si dhe të gjithë dokumentat e përpunuara të shoqërisë, si bilancet, llogaritë ekonomike etj.
- Të bëjë propozime dhe t'i paraqesë ato për shqyrtim para organeve të shoqërisë.
- Të emergojë dhe të shkarkojë përfaqësuesit e tij, punonjësit, ekspertin kontabel dhe likuidatorët.

NENI 6

Ortakët kanë këto detyrime kryesore:

- Të depozitojë kuotën e tij dhe kuotat suplementare në përputhje me kontratën dhe statutin.
- Të marrë pjesë në administrimin e shoqërisë nëpërmjet organeve të krijuara nga vete ai.
- T'i japë shoqërisë të dhënat e domosdoshme për përpunimin e çdo objekti të vecantë lidhur me veprimtarinë e saj.
- Të kryejë detyrat për realizimin e objektivave dhe të funksioneve të shoqërisë.
- Ortaku ka të drejtë të heqë dorë nga shoqëria, duke i njoftuar vendimin e tij asamblese së ortakut në rast shtimi të ortakëve 6 muaj përpara dhe duke ceduar të drejtën e zgjedhjes.
- Heqja dorë nuk e liron ortakun nga detyrimet e marra me pare ndaj shoqërisë dhe nuk pezullon detyrimet e shoqërisë ndaj ortakut.
- Të japë shoqërisë informatat e nevojshme që kanë të bëjnë me ecurinë e veprimtarisë së saj.
- Të kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.
- Pjesëmarrja në shoqëri nuk i pengon ortakët të kenë pavarësi ligjore për veprimtari të tjera dhe për të drejta të tjera pronësie. Ai nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë që rrjedhin nga objekti i veprimtarisë së saj tej kapitalit themelor ku ata kanë marrë pjesë.

KREU III-te

Kushtet Ekonomike

NENI 7



Veprimtaria e shoqërisë realizohet në baze të leverdise ekonomike dhe pasqyrohet në bilancet e saj. Bilanci vjetor i shoqërisë nxirret brenda 31 Marsit të vitit pasardhës. Çdo vit financiar fillon më 1 Janar dhe perfundon më 31 Dhjetor.

NENI 8

Llogarite vjetore, inventari, raportet operacionet e veprimtarise se vitit financiar dhe raportet e vecanta te hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga Asambleja. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

NENI 9

Per te bere te mundur zhvillimin e veprimtarise se shoqërisë, vihet nje kapital baze qe perben burimin fillestar per krijimin e fondit themelor dhe te mjeteve te xhiros.

NENI 10

Kapitalit themeltar i shoqërisë eshte 10.000 leke, qe i takon ortakeve themelues si me poshte:

- 1. Z. LUAN SHABA** zoteron 1 kuote, me vlere 50% te kapitalit;
- 2. Znj. ENI SHABA** zoteron 1 kuote, me vlere 50% te kapitalit.

NENI 11

Kur shoqëria pushon veprimtarine e saj, pasi shlyen te gjitha detyrimet qe ka, pjesen e mbetur te kapitalit dhe te te ardhurave e marrin ortakët themelues.

Pitimi neto i realizuar nga shoqëria, mbasi zbriten te gjitha detyrimet si edhe fondet e lena rezerve per nxitjen ekonomike, per investime, per reklamen tregtare etj, perfitohen prej ortakeve themelues te kesaj shoqërie.

Ortakët perballojne humbjet e shoqërisë deri ne kufirin e vleres se tyre te derdhur ne formimin e kapitalit themeltar. Ne rast zmadhimi te kapitalit themeltar nepermjet shtimit te tij, ortaku ka te drejten e rritjes se tij.

Pjeset e kapitalit themeltar jane plotesisht te transferueshme ne rruge trashegimie ne rast ndarje pasurie ndermjet bashkeshortëve dhe nepermjet paraardhesve dhe pasardhesve.

Shoqëria ne emer te vet eshte pronare, perdoruese dhe disponuese e pasurive te saj, por gjithmone ne perputhje me qellimin e objektin e veprimtarise qe ajo kryen.

Shoqëria mund te shese pasuri ose te shfrytezoje te drejta te tjera materiale. Ajo mund te ofroje per garanci edhe pasuri te saj per te marre kredi bankare.

Shoqëria krijon fonde rezerve ose dhe fonde te tjera te vecanta per zhvillimin dhe nxitjen ekonomike te saj.

NENI 12

Shoqëria eshte pronare e pasurive te saj dhe ka te drejte te perdorimit dhe disponimit te kesaj pasurie, ne perputhje me qellimin dhe objektin e veprimtarise qe kryen. Shoqëria gezon te drejttat per mbrojtjen e pasurise se saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 13

E ardhura bruto e shoqërisë, pasi zbritet amortizimi i te gjithë pasurise se lujteshme e te palujteshme, sipas afateve te caktuara, kuotat qe kane te bejne me kredite per investimet, pagat e shtesat mbi pagat, shpenzimet per lendet e para apo ndihmese, energjine si dhe



shpenzimet e pergjithshme te sanksioneve te shoqerise dhe ato per qellime te tjera prodhuese e joprodhuese, i takojne ortakeve te shoqerise.

KREU IV-te

Administrimi

NENI 14

Organi vendimor i shoqerise eshte Asambleja e Ortakeve

Mbledhja e Asamblese mund te thirret nga administratori, nga eksperti kontabel i autorizuar. Mbledhja e Asamblese mblidhet dhe merr vendime ne baze te nenit 86 dhe 87 te ligjit Per Shoqerite Tregtare.

Asambleja thirret se paku nje here ne vit, duke lajmeruar me shkrim 30 dite perpara.

NENI 15

Asambleja e Ortakeve merr vendime per cdo aspekt te veprimtarise se shoqerise.

Kompetencat ekzekutive te Asamblese se Ortakeve te shoqerise jane:

1. Percaktimi i te drejtave kryesore te veprimtarise se shoqerise.
2. Ndryshimet ne emertesen e prodhimit qe do te realizohet dhe te punimeve qe do te kryhen, qe jane pjese perberese e objektit te veprimtarise se shoqerise.
3. Propozimet e nevojshme per ndryshimet ne kapitalin baze te shoqerise.
4. Percaktimi i regjimit dhe i kushteve te zbatimit te parimeve te llogarise ekonomike.
5. Percaktimi i rregullave dhe i normave, qe perkufizojne raportet me gjirin e shoqerise, duke perfshire edhe kuadrin e personelit.
6. Percaktimi i struktures se aparatit te shoqerise.
7. Percaktimi i organikes dhe ndarja e vendeve drejtuese ndermjet perfaqesive te ortakeve.
8. Emertimi dhe zevendesimi i Administratorit te pergjithshem te shoqerise.
9. Krijimi i organeve te tjera te domodoshem per realizimin e objektivave te shoqerise.
10. Percaktimi i madhesise se kuotave per formimin e kapitalit baze te shoqerise.
11. Paraqitja e propozimeve per rregullimin, krijimin dhe perfitimin nga fondet e vecanta, ndarjen e fitimeve dhe percaktimi i rregullave per shlyerjen e borxheve.
12. Marrja e vendimit per krijimin e filialeve te degeve e te perfaqesive si dhe per cedimin e veprimtarise se tyre.
13. Percaktimi i rregulloreve per proceduren e punes te administrates.
14. Pergatitja e propozimit per pushimin e veprimtarise se shoqerise.
15. Perzgjedhja e antareve per komisionin e likujdimit te cilet emrohen dhe revokohen nga Asambleja e Ortakut.
16. Kryerjen e veprimtarive per likujdimin e llogarive, qe i perkasin ortakut doreheqes te shoqerise.
17. Marrjen e vendimit per kerkimin dhe perdorimin e kredive afatgjata.

NENI 16

Veprimtaria operative e shoqerise drejtohet nga Administratori i saj i Pergjithshem. Ne shoqerine "ASIA 2021" sh.p.k. administrator i shoqerise do te jete:

Z. LUAN SHABA, atesia Elmaz, i dtl. 13.08.1985, lindur ne Durres dhe banues ne Durres madhor dhe me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, shtetas shqiptar, identifikuar nga leternjoftimi nr. I50813062W; i cili ne te njejten kohe ka edhe funksionin e perfaqesimit te shoqerise me te tretet ne gjithe veprimtarine e saj.

Administratori emerohet per nje kohezgjatje prej 5 (pese) vjetesh financiare.
Me miratimin e ortakut mund te emrohen administratore dhe perfaqesues te tjere te shoqerise "ASIA 2021" sh.p.k.

Administratori emerohet per nje kohezgjatje prej 5 (pese) vjetesh financiare me perjashtim te rasteve te doreheqjes ose shkarkimit te parakohshem. Administratori ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet ne interes te shoqerise dhe ne emer te saj nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e veprimtarise se shoqerise me perjashtim te atyre kompetencave qe ligji nuk i njeh. Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise apo te treteve per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit apo per faj te tij gjate administrimit te shoqerise.

Kopetencat e administratorit ne shoqeri jane:

- Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre ne kuadrin e veprimtarise se shoqerise.
- Te beje propozimet e nevojshme ne mbledhjen e asamblese kur lind nevoja e kapitalit themeltar te shoqerise.
- Te miratoje akte normative qe percaktojne raportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin dhe personelin.
- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise.
- Te krijojte organe te tjera te domosdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.
- Te propozoje ne mbledhjen e asamblese per krijimin e njesive, srukturave si filiale, dege e perfaqesi ne qytete te tjera te vendit apo jashte shtetit.
- Te pergatise propozimet per pushimin e veprimtarise se shoqerise dhe t'ia paraqesin ato Asamblese per miratim.
- Te perzgjedhi ekspertet kontabel dhe anetaret e komisionit te likujdimit dhe te paraqesin propozimet per miratim ne asamble.
- Te siguroje zbatimin e perpikte te vendimeve te asamblese.
- Te percaktoje numrin e punonjesve te shoqerise dhe pagat e tyre.

-Organizon punen per realizimin e planeve te shoqerise dhe raporton per to ne perputhje me programet e planet e pergjithshme, administron pasurine e shoqerise, duke perfshire ketu mjetet financiare, brenda caqeve te vendimeve te marra nga organi administrativ i shoqerise.

-Drejton e kontrollon veprimtarine e filialeve te degeve e te perfaqesive.

-Perfaqeson shoqerine perpara te treteve si gjykate etj.

-Nenshkruan kontrata ne emer e per llogari te shoqerise dhe siguron venien e tyre ne jete.

-Merr te gjitha vendimet qe kane te bejne me ato veprimtari te shoqerise, qe nuk jane ne kompetence ekzekutive te Asamblese se Ortakut.

-Raporton dhe i pergjigjet Asamblese per zbatimin e veprimtarive te shoqerise si dhe per realizimin e objektivave dhe detyrave qe jane ne kompetence te tij.

-Siguron drejtimin e shoqerise.

-Perfaqeson shoqerine ne lidhje me te tretet brenda caqeve te objektit te veprimtarise se saj, pervec ceshtjeve qe kerkojne unanimitetin e ortakeve ose qe kane te bejne me kompetencat qe ky statut i atribuon Asamblese se Ortakut.

-Organizon zbatimin e sakte te vendimeve te Asamblese se Ortakut.

-Ben hapjen e leter kredive ne leke e ne valute te huaj.



Per te kontrolluar veprimtarine financiare te shoqerise e te filialeve te saj krijohet komisioni i revizionimit kontabel.

Kryetari dhe antaret e ketij komisioni emerohen nga Asambleja e Ortakut. Kryetari i komisionit emerohet per cdo mandat nga Asambleja.

Komisioni i Revizionimit kontabel perbehet nga 3-5 vete dhe qendron ne detyre per nje periudhe prej tre vjetesh.

Kryetari dhe antaret e komisionit nuk mund te jene ne varesi te shoqerise ose filialeve te saj.

Komisioni i Revizionimit kontabel eshte pergjegjes per veprimtarine e vet perpara Asamblese se Ortakut dhe eshte i detyruar ti paraqese asaj cdo vit raport per kontrollet e bera si dhe konkluzionet per bilancet vjetore.

NENI 18

Mardheniet e punes ne shoqeri

Marrdheniet e punes ne shoqeri e filiale, ne dege e perfaqesite rregullohen ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise, legjislacionin shqiptar, me kete statut si dhe nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk rregullohen ne kontraten e punes, zbatohen dispozitat e legjislacionit te punes. Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet mbi bazen e kontrates kolektive dhe individuale te punes.

Ne kontraten e punes rregullohen keto ceshtje:

Kushtet dhe menyra e marredhenies se punes;

Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tij ne vendin e punes;

Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes, puna e nates, puna jashte kohes normale, puna ne ditet e pushimit javor, festave zyrtare;

Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes;

Pushimet dhe mungesat, te drejtat, detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve per zbatimin e detyrave te punes;

Pushimi i marredhenies se punes;

Paga e punes se punonjesit, shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj ne organet perkatese duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet e caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Per te gjitha mosmarreshjet qe mund te lindin gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e rrethit Gjyqesor Durres.

KREU V-te

Mbyllja e Shoqerise:

NENI 19

Veprimtaria e shoqerise pushon me propozimin te ortakut, kur gjate dy vjeteve nuk rezulton rentabel ose kur ortaku heq dore nga shoqeria si dhe te gjitha rastet qe parashikohen ne dokumentet e krijimit te shoqerise. Shoqeria shperndahet ne forme riorganizimi ose likujdimi.

Afati i veprimtarise se shoqerise caktohet i pakufizuar duke filluar nga viti 2021, si vit i pare i veprimtarise.

NENI 20

Kur shoqeria likujdohet:



Asambleja e ortakut emeron likujdatorin, te cilit i paraqitet bilanci dhe shoqeria i jep fund veprimtarise se saj ne castin e miratimit te ketij raporti te hartuar.

Pasurite qe jane vene ne dispozicion te shoqerise me te drejte shfrytezimi, shiten ne varesi te shkalles se konsumit te tyre. Te ardhurat cedohen ndermjet ortakeve ne perpjetim me kuoten e vene. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se shoqerise e te fililave te saj dhe fondet financiare ndahen ndermjet ortakeve ne perpjestim me kuotat e vena, pasi te jene bere pagesat per kreditoret.

NENI 21

Kur pushon veprimtaria e nje filiali, per efekte te riorganizimit te tij, afatet e pushimit caktohen nga Asambleja e Ortakut. Likujdimi i filialeve behet njelloj si per shoqerine. Mjetet financiare te fituara si rezultat i veprimtarise se filialit te likujduar dhe fondet e tij financiare vihen ne dispozicion te shoqerise pasi tu jene bere pagesat likujdatoreve.

NENI 22

Ku statut hyn ne fuqi menjehere.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

LUAN SHABA

Perf. Nga Sherif Konçi

Sherif Konçi


ENI SHABA

Perf. Nga Sherif Konçi

Sherif Konçi




PROKURË E POSAÇME

Gjenevë më.22.Mars.2021

Ne shtetasit **Z.Luan Shaba** identifikuar me karte identiteti nr.**15081306W** dhe **Znj.Eni Shaba** identifikuar me karte identiteti nr.**J26105078D** lëshojme kete prokurë të posaçme, si më poshtë vijon:

Ne, te përfaqësuarit, emërojmë si përfaqësues të posaçem **Z.Sherif Konçi** i dtl.03.05.1958, identifikuar me karte identiteti nr.**F80503163A**, të cilit i japim të drejta dhe kompetenca të plota që në emër dhe për llogarinë tone, te nenshkruaj aktet perkatese per themelimin e nje shoqerie tregtare ne te cilen ne do te rezultojme ortake me 100 % te kuotave, duke patur te drejte te paraqitet para çdo zyre noteriale per te nenshkruar Akt Themelim/Statut si edhe te gjitha aktet perkatese ne emrin tim.

Pasi shoqeria te themelohet, perfaqesuesi ka te drejte te na perfaqesoje ne çdo mbledhje asambleje dhe te nenshkruaj per çdo çeshtje sipas gjykimit te tij.

Si me lart, perfaqesuesi ka te drejte te paraqitet para QKB-se, Drejtorise se Tatimeve, Drejtorise se Doganave, Bashkise si edhe para çdo institucioni te administrates publike dhe private ne lidhje me kete shoqeri, duke patur te drejte te nenshkruaj ne emrin tone.

Autorizojme perfaqesuesin te caktoj administratorin si dhe ta perfaqesoj administratorin ne cilesine e perfaqesuesit ligjor te shoqerise me te drejta te plota duke i dhene te drejten te veproj ne banke si dhe para cdo institucioni te administrates publike dhe private, pa asnje kufizim.

Kjo prokurë i shtrin efektet e saj për sa kohë nuk është shfuqizuar prej nesh.

TE PERFAQËSUARIT:

Luan Shaba

Eni Shaba

Seen exclusively for the legalization of the signatures, apposed on the recto side of this page, of Mrs Eri SHABA and Mr Luan SHABA.

Geneva, the 22nd of March 2021.



**DUCRET
& YOUSFI
RIGAUD**
Boulevard Helvétique 26
CH-1207 Genève
T +41 (0)22 591 03 03
F +41 (0)22 591 03 00

APOSTILLE

(Convention de La Haye du 5 octobre 1961)

1. Pays : Suisse
Le présent acte public
2. a été signé par Me Pierre-Philippe RIGAUD.--
3. agissant en qualité de notaire --
4. est revêtu du sceau/timbre de notaire --

Attesté

5. à Genève
6. le 24 MARS 2021
7. République et Canton de Genève
8. sous N° 908729
9. Sceau/timbre :
10. Signature :

Emmanuel Moar

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE DURRËS
NOTER JULED A. BEQIRAJ



V2021011520088437380

DATE 15/04/2021
NR REP 1971

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 15.04.2021, para meje Noter JULED A. BEQIRAJ, anëtar në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore DURRËS, me zyrë në adresën Durrës, NR.4, EGNATIA, u paraqit personalisht:

NËNSHKRUES/IT: 1.Luan Shaba, atësia Elmaz, amësia Nazmije, shtetas Shqiptar, lindur në Durrës dhe banues në DURRËS, me adresë Anastas Durrsaku 00690058; Nd. 96; H. 8; Ap. 34; Durrës; Durrës; 2003; Durrës, lindur më 13/08/1985, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me ID nr. 033437519 dhe nr. personal I50813062W , , përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e huaj", në datë 22/03/2021, nga përfaqësues **Sherif Konçi**, atësia Baki, shtetas shqiptar, lindur në Romanat, Durrës dhe banues në Durrës, lindur më 03/05/1958, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga karta e identitetit me nr. personal F80503163A;

2.Eni Shaba, atësia Sherif, amësia Liljana, shtetase Shqiptare, lindur në Durrës dhe banues në DURRËS, me adresë 17 Janari 00690007; Nd. 119; H. 1; Ap. 13; Durrës; Durrës; 2003; Durrës, lindur më 05/11/1992, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me ID nr. 033450941 dhe nr. personal J26105078D , , përfaqësuar me prokurë të tipit "Prokure e huaj", në datë 22/03/2021, nga përfaqësues **Sherif Konçi**, atësia Baki, shtetas shqiptar, lindur në Romanat, Durrës dhe banues në Durrës, lindur më 03/05/1958, madhor me zotësi të plotë juridike dhe për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova nga karta e identitetit me nr. personal F80503163A;

te cilet deklaruan se akt themelimi dhe statuti jane redaktuar sipas vullnetit te tyre, e nenshkruan ne pranine time, dhe une Noteri pasi u binda per identitetin e tyre nepermjet dokumentave perkatese lejoj nenshkrimin dhe e legalizoj ate sipas ligjit.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noteri deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.



NOTER

JULED A. BEQIRAJ